

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

“MICULI ENERGJI” sh.p.k

Tiranë 01.08.2018

Me cilësinë e ortakëve themelues të shoqërisë **“MICULI ENERGJI” sh.p.k** ;

- “MICULI” shpk, me NIPT-K67313002F, me seli, Shkodër, lagje “Tre Herojt”, rruga “Marin Biçikemi”, godinë 2 katëshe, kati 2 nr.7/532-N9, data e regjistrimit 21.09.2006, me administrator Viktor Miculi, objekti kryesor i veprimitarisë ndërtim dhe tregti.
- “Selca Enegji” shpk, me NIPT- K98510701M, me seli Koplik, godinë një katëshe 50m larg shkollës 9 vjeçare, Selce. Data e regjistrimit 30.10.2009, me administrator Rudinë Gjoni dhe Sebastian Pjetri.
Me objekt veprimitarie kryesore prodhim e shitje të energjisë elektrike.
- “MATEO S CO” shpk, me NIPT-L61720018E, me seli Shkodër, Kelmend Tamare, njësia administrative Kelmend, Tamare, Hec Muras, në pellgun e Cemit të Selces, me perfaqësues ligjor (administrator) Elona Nikolli.
Me objekt veprimitarie prodhim e shitje të energjisë elektrike.

Në cilësinë e ortakëve themelues, me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, kanë themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“MICULI ENERGJI” sh.p.k.** (më poshtë e quajtur “Shoqëria”)



KREU I



Neni 1
Krijimi

Shoqëria **“MICULI ENERGJI”** sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin në QKR.

 Sebastian Pjetri  Elona Nikolli

 Viktor Miculi
 Elona Nikolli

Shoqëria “***MICULI ENERGJI***” sh.p.k, është një shoqëri tregtare e themeluar nga ortaket e sipershkruar, te cilit nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortakët gëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në Shkodër, lagje “Tre Herojt”, rruga “Marin Biçikemi”, godine 2 kateshe, katër 2 nr.7/532-N9.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4
Objekti i veprimitarisë

Objekti i veprimitarisë së shoqërise është në përputhje me legjisacionin Tregtar aktual Shqiptar dhe do të jetë :

- Projektim, Ndertim dhe shfrytëzim hidrocentralesh.
- Prodhim dhe shitje energjje elektrike .
- Import – eksport e tj. sipas legjisacionit ne fuqi.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papërcaktuar.

***KREU II
KAPITALI***

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke , i ndarë në 3 kuota.

Kuotat e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët e shoqërisë si më poshtë :



- “MICULI” shpk; me NIPT-K67313002F, me seli Shkoder, lagje “Tre Herojt”, rruga “Marin Biçikemi”, godinë 2 katëshe, kati 2 nr.7/532-N9.
Zotëron 1 kuotë, që përfaqëson 75% të kapitalit, në vlerë 75.000 lekë.
- “Selca Enegji” shpk, me NIPT- K98510701M, me seli Koplik, godinë një katëshe 50m larg shkollës 9 vjeçare, Selce.
Zotëron 1 kuote, zotëron 12.5 % të kapitalit, në vlerën 12.500 leke.
- “MATEO \$ CO” shpk , me NIPT-L6172001E, me seli Shkodër ,Kelmend Tamare, njësia administrative Kelmend, Tamare, Hec Muras, në pellgun e Cemit të Selces,
Zotëron 1 kuote, zotëron 12.5 % të kapitalit , në vlerën 12.500 lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakve me vendim unanim të ortakëve, duke kontribuar në para ose me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, si dhe nga fitimet e shoqërisë .

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.

Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë.

Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur Gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuatat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;

- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

Neni 9
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si :


- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- d) thirrjen e mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.



Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10
Administrimi

Administrator i shoqërisë është; **Viktor Miculi**; emri i babait Llesh ,emri i nënës Gjyste ,Shtetas Shqiptare lindur ne Buze UJIT, Koplik, Me 02.03.1967 ,me nr.ID 032942367 dhe nr.personal G70312035F, banues; Shkoder, lagje 5, “Tre Herojt”, rruga “Marin Biçikemi”, godine 2 kateshe, kati 2 nr.7/532-N9.

Neni 11
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:


- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe të dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.



Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshи këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimi i ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12
Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3.Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta, kanë realizuar nga këto veprime të



parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe perfundon më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë finanziar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet më 31 dhjetor.

Neni 14
Bilanci i shoqërisë dhe dividentët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithsme, miraton bilancin e paraqitur nga administratori.

Mbledhja e ortakëve të shoqërisë vendos rrëth shpérndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji dhe statutati i shoqërisë.

Neni 15
Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë Asamblesë së Përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.



Neni 16
Dividenti

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, Asamblesë së Shoqërisë, të cilat mund të kalojnë dhe për zmadhimin e kapitalit me vendim unanim të ortakëve .

Fitimi që mund të shpérndahet tek ortakët (Dividenti) konsiston në fitimin e viti aktual, dhe ndahet mes ortakëve ;

Shoqëria do të fillojë të shpérndajë Dividenti në fund të vitit që fillon shitja e energjisë elektriqe, sipas bilancit të vitit ushtrimor për ortaktë si më poshtë;

- “Selca Enegji” shpk, me NIPT- K98510701M, me seli në Koplik, ortak i cili zotëron një kuote, me vlerë 12.5 % të kapitalit të shoqërisë, do të përfitojë divident në vlerën e 10% të vlerës së shitjeve të vitit ushtrimor duke i zbritur tatim fitimin mbi këtë vlerë.
- “MATEO \$ CO” shpk, me NIPT-L6172001E, me seli Shkodër, ortak i cili zotëron një kuotë, me vlerë 12.5 % të kapitalit të shoqërisë do të përfitojë divident në vlerën e 10% të vlerës së shitjeve të vitit ushtrimor duke i zbritur tatim fitimin mbi këtë vlerë.
- “MICULI” shpk, me NIPT-K67313002F, me seli, Shkoder, lagje ”Tre Herojt” ,rruga ”Marin Biçikemi”, godinë 2 katëshe, kat 2 nr.7/532-N9. Zotëruesh i një kote, me vlerë 75 % te kapitalit të shoqërisë, do të shpérblehet me divident me pjesën e mbetur të fitimit neto të vitit ushtrimor, mbas zbritjes së dividentit që do t’iu paguhet të dy ortakëve të minorancës sipas përcaktimit të mësipërm.

Neni 17
Shpérndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të Gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë



shoqëri aksionere.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare.


Neni 26
Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua ortakëve themeltar të shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë nga ortakët themelues.


Autorizohet administratori i shoqërisë që të kryejë cdo procedurë të nevojshme lidhur me depozitimin e statutit në QKR dhe regjistrimin e shoqerisë .

ORTAKËT E SHOQËRISË “***MICULI ENERGJI***“ sh.p.k

“MICULI” shpk, me NIPT-K67313002F,
Perf. Ligjor. Viktor MICULI



“Selca Enegji” shpk, me NIPT- K98510701M,
Perf. Ligjor. Sebastian PJETRI.



“MATEO & CO” shpk , me NIPT-L61720018E,
Perf. Ligjor. Elona NIKOLLAJ.

